



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 07.10.2013
Nr. 0203 - 1295

PËR: Agim Aliu , Kryetar i Komunës së Ferizajt
Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES TË KOMUNËS
SË FERIZAJT, Nr. 01 - 28, Pranuar me datë, 03.10.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Rregullores Nr. 01 - 28, të miratuar me datë 28.03.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Rregullore Nr. 01 - 28, për Barazi Gjinore në Komunën e Ferizajt.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 07.10.2013
br. 0203 - 1295

Za: Agim Aliu , Gradonačelnik opštine Uroševac
Xhavit Zariqi, Predsedavajući Skupštine opštine Uroševac

Predmet: Potvrda zakonitosti uredbe Skupštine opštine Uroševac
br. 01 - 28, Priljeno dana , 03.10.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja uredbe br. 01 - 28, odobreno dana 28.03.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Uredba br. 01 - 28, o rodnoj ravnopravnosti opštine Uroševac.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13, si dhe nenin 58, pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (G.Z. e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 60, pika 8 dhe 11 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01. Nr.33, të datës 26.11.2008, si dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit Kundër Diskriminimit, Ligjit të Shërbimit Civil, Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, si dhe dispozitave të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Kryetari i Komunës së Ferizajt, propozon këtë:

DRAFT RREGULLORE PËR BARAZI GJINORE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 QËLLIMI

1. Me këtë Rregullore trajtohet dhe vendoset barazia gjinore si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë në Komunën e Ferizajt. Mbrohen mundësitë dhe kontributet e barabarta në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore në nivelin lokal.

Neni 2 PËRKUFIZIMET

1. "Barazi gjinore" do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës, pozitë e barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfundim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.
2. "Trajtim i barabartë gjinor" do të thotë mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.
3. "Diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor" do të thotë trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme.
4. "Diskriminim i tërthortë gjinor" do të thotë vënia e individit të njëjës gjini në pozitë jo të barabartë me dispozitat asnjansëse, standardet apo trajtim të pabarabartë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, përveç rasteve kur këto dispozita, standarde apo ky trajtim është i domosdoshëm dhe nëse mund të justifikohet me fakte objektive që nuk bazohen posaçërisht në ndonjërin gjini.
5. "Parimin e trajtimit të barabartë" që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës.

paatësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera.

6. "Masat ligjore" janë masa të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëmarrëse të gjinisë së caktuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese ose t'u sigurohen të drejta të cilat më herët nuk iu kanë takuar.

7. "Masat e përgjithshme" janë masa të natyrës normative, përmes të cilave diskriminimi gjinor parandalohet me anë të ligjeve të cilat i rregullojnë fushat e veçanta, sjelljet në rrethana të caktuara apo qasjen e duhur për garantimin e trajtimit të barabartë gjinor, siç janë ndëshkimet që duhet ndërmarrë ndaj individëve në rast të shkeljes së këtyre kufizimeve ose kërkesave.

8. "Masat e veçanta" janë masa të përkohshme të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushat specifike të jetës shoqërore, në të cilat është identifikuar përfaqësimi i pabarabartë gjinor apo pozita e pabarabartë e personave që i përkasin njëres gjini.

9. "Përfaqësimi i pabarabartë" është atëherë kur përfaqësimi i njëres gjini në një fushë të posaçme shoqërore apo në një segment të kësaj fushe, është më i ulët se 40%.

Neni 3

BARAZIA GJINORE NË INSTITUCIONET DHE ORGANET UDHËHEQËSE TË KOMUNËS

1. Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të institucioneve publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të jetë në harmoni me numrin e popullatës së përgjithshme të komunës.

2. Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione dhe organe udhëheqëse apo në nivele të pushtetit është 40 %, sipas nenit 3.2 të Ligjit për Barazi Gjinore.

3. Gjatë emërimit në pozita të larta në institucionet e komunës si dhe gjatë rekrutimit nëpër të gjitha nivelet komunale, duhet të respektohet pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në përputhje me Nenin 3 pika 2.

4. Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Komunës duhet të përfillojnë përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këto organe përfaqësuese.

5. Institucionet e komunës, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politika për barazi gjinore, miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.

Neni 4

VENDIM MARRJA

1. Vendimet që merren nga organet vendimmarrëse si: Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Ferizajt, mundësisht të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore nga zyra për barazi gjinore.

2. Shërbimi civil në sajë të paanshmërisë, profesionalizmit, përgjegjshmërisë reflekton barazinë gjinore.

3. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, ai politik, aftësitë e kufizuara, statusi ekonomik, martesor, moshë ose prejardhja etnike.

Neni 5 PARTITË POLITIKE

1. Partitë politike të regjistruara në regjistrin e partive politike, përcaktojnë metodat dhe masat për përfshirjen dhe përfaqësimin gjinor në kryesitë dhe komisionet brenda partive politike në pajtim me nenin 3.2 të Ligjit për Barazi Gjinore.
2. Përfaqësim gjinor në kryesitë e partive politike.
3. Përfaqësim gjinor në komisionet brenda partive politike.
4. Përfaqësim gjinor në raste të koalicionit apo të marrjes së pushtetit.

Neni 6 EKONOMIA DHE ARSIMI

1. Organet përgjegjëse të komunës në përgjithësi si dhe institucionet financiare në veçanti, obligohen t'u sigurojnë femrave qasje në mjete dhe shpërndarje të mjeteve të ndara për nxitjen e krijimit të biznesit dhe vetëpunësimit (masa afirmative).
2. Në procesin e planifikimit të buxhetit, komuna të siguroj mbajtjen e tubimeve, dëgjimeve publike dhe të inkurajoj pjesëmarrjen e grave.
3. Komuna të bëjë stimulimin e programeve për gratë ndërmarrëse nëpërmjet krijimit të mundësive për qasje në pronë.
4. Në të gjitha nivelet e edukimit dhe arsimit të mundësohet arsimimi dhe edukimi i barabartë i femrave dhe meshkujve për pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri, në jetën familjare dhe në tregun e punës.
5. Drejtoria për arsim dhe drejtoritë shkollore, obligohen të zbatojnë dhe mbikëqyrin politikat e veprimit për sigurimin e barazisë gjinore me qëllim të trajtimit të njëjtë të femrave dhe meshkujve, veçanërisht për sa i përket: qasjes në arsim dhe edukim, përfshirjes së femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimimit profesional dhe të këshillimit për ato profesione të cilat deri tani janë konsideruar tradicionalisht (stereotipizimi) si profesione vetëm për meshkuj ose vetëm për femra.
6. Në shkollë ndalohet çdo lloj diskriminimi gjinor ndaj stafit të mësimdhënies, nxënësve si dhe personelit teknik.

Neni 7 MBROJTJA SOCIALE

1. Në legjislacionin komunal të politikave të mbrojtjes sociale të mundësohet qasja e plotë dhe e barabartë duke rritur numrin e shërbimeve për gratë e varfra dhe kryefamiljare.

Neni 8 MEDIAT

1. Të gjitha mediat lokale (mediat e shtypura, media audiovizuale, media elektronike) duhet të ndikojnë në kultivimin e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe meshkujve, duke promovuar rolin e barabartë të femrave dhe meshkujve në shoqëri.
2. Ndalohet emetimi i programeve, botimi dhe publikimi i materialeve dhe informatave si dhe shpërndarja e informatave në formën elektronike mbi baza të diskriminimit gjinor.
3. Ndalohet shfaqja publike dhe paraqitja e çdo individi në mënyrë ofenduese, nënçmuese apo poshtëruese për sa i përket gjinisë.

Neni 9
SHOQËRIA CIVILE DHE BARAZIA GJINORE

1. Komuna të bashkëpunojë me organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera të shoqërisë për avancimin e barazisë gjinore në komunën e Ferizajt sipas nenit 11 të Ligjit për Barazi Gjinore.

Neni 10
PUNËSIMI

1. Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e kandidatëve për vende pune në çdo degë veprimtare, në të gjitha shkallët profesionale, në sektorin publik të vendosen mbi bazat e barazisë gjinore.
2. Ndalohej diskriminimi mbi bazat gjinore në rast të zvogëlimeve dhe mbylljes së vendit të punës.
3. Ndalohej çdo lloj tyerje që cenon dinjitetin njerëzor të punëtorëve në vendin e punës në baza gjinore.

Neni 11
BUXHETIMI GJINOR

1. Institucionet e komunës në të gjithë sektorët duhet të shqyrtojnë mundësi që të sigurojnë ndarjen dhe menaxhimin e financave publike përmes aplikimit të buxhetimit gjinor, ndarjes së drejtë të buxhetit në baza gjinore.
2. Institucionet e komunës gjatë hartimit të politikave të komunës, proceset e planifikimit të buxhetit, të planifikojnë buxhet për të dy gjinitë duke marrë për bazë prioritetet e femrave dhe meshkujve.
3. Zyra për barazi gjinore do të ndihmojë në mbledhjen, evidentimin dhe analizën e të dhënave tek çdo lloj anketimi tjetër për t'u ardhur në ndihmë drejtorive dhe shërbimeve të tjera komunale në rast nevojë të hartimeve të dokumenteve të barazisë gjinore.

Neni 12
Hyrja Në Fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi, datën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Nr. _____
Më dt. ____/____/2013
Ferizaj.



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Avrit Zariqi